

**Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët
për vitin akademik 2019/2020
Programi: Menaxhment Industrial**

1. Hyrja

Programi Menaxhment Industrial (MI) ne kuadër te Fakultetit te Menaxhmenti gjate vitit akademik 2019/20 ka ofruar mësim për studentet sipas plan-programit te Akredituar ne vitin 2019 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), vlerësimi për stafin akademik/lëndën ka filluar nga i njëjti vite. Fakulteti Menaxhmenti ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente moderne të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë shkathhtësitë e duhura për profesionin, të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Misioni i programit është të krijoj profesionist në fushën e Menaxhmentit Industrial, me fokus në fushën e administrimit të biznesit dhe inxhinierisë, duke ndihmuar në strukturimin dhe organizimin e kompanive industriale për të përmirësuar zhvillimin e kompanisë si dhe gjenerimin e ideve që avancojnë praktikën e menaxhimit; Misioni i programit është në harmoni të plotë me misionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Raporti përmban te dhëna për vlerësimin e programit nga studentet – i cili është realizuar ne nivel te universitetit i cili përmban edhe vlerësimin ne nivel programit MI - dhe për vlerësimin e stafit akademik/lëndës nga studentet ne programin MI.

2. Raporti i përmbledhur i vlerësimit të cilësisë (program dhe stafi akademik/lënda)

Raporti i përmbledhur - për dy fushat (program dhe staf akademik/lëndë) paraqet ne Tabelën nr. 1 – te dhënat për vitin akademik 2019/20, i ilustruar edhe ne Fig.1. Pyetjet për dy fushat kanë qenë të ndërhuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4-Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

Tabela.nr.1 - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave

	Vitët Paraprake		Viti aktual
	2017/18	2018/19	2019/20
Vlerësimi mësimdhënia/nxënia (programi)	3.12	3.80	4.00
Vlerësimi i stafit akademik / lëndë	4.30	4.26	4.38




Fig.1 – Grafika - vlerësimi i cilësisë sipas fushave,

Nga raporti përmbledhur i paraqitur në tabelën nr.1 dhe i pasqyruar ne grafikun nr.1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënies dhe mësimnxënies shohim përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë neper tri vitet akademike - nga 3.12 ne vitin akademik 2017/18, ne 3.8 ne vitin akademik 2018/19 dhe ne vitin aktual 4.00 apo vlerësimi ne përqindje nga studentet për programin është 80% - një vlerësim i shume i mire. Ne kuadër te fushës te vlerësimi i stafit akademik/lëndës është një vlerësim konstant neper tri vite nga studentët, për te tri vitet akademike vlerësimi është me notën mesatare mbi 4.3 apo rreth 86% është vlerësimi ne përqindje i studenteve për stafin akademik/lëndën, është një vlerësim i shkëlqyeshëm.

3. Raporti i vlerësimit të Programit

Vlerësimi i programit 2019/20 është ne nivel te universitetit i cili përmban edhe vlerësimin e programit MI për atë vit akademik (krahasuar me vitin akademike paraprake), vlerësim është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 20 komponente, ky vlerësim realizohet një herë brenda viti akademik. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe

vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së Likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Bazuar në rezultate e vlerësimit të paraqitura në tabelën nr.2, vërejmë se të gjitha komponentët e këtij sesi janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare e vlerësimit të programit është 4.00 një vlerësim jashtëzakonisht i mirë.

Tabela nr.2 – Vlerësimi i programit – MI

	Viti paraprak	Viti aktual
	2018/19	2019/20
Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave ju ofrohen studentëve rregullisht	4.27	4,25
Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	4.90	4,17
Syllabuset e lëndëve ofrohen me kohë studentëve	4.22	3,99
Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	4.17	3,89
Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	3.55	4,29
Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse	4.40	4,00
Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	3.42	3,28
Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shume nga ai në klasë	///	4,34
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve	///	3,96
Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë	3.98	3,74
Ekziston një lidhje e mirë e mësimi teorik dhe atij praktik	2.95	4,34
Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore	4.57	4,22
Orari i mësimi shpallet me kohë	4.32	4,07
Orari i shpallur i mësimi respektohet nga mësimdhënësit	3.90	3,99
Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	4.05	3,91
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera	3.00	3,87
Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar)	///	3,62
Vlera e ECTS-së për lëndën është e llogaritur sipas ngarkesës së studentit	3.80	///
Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti	2.80	3,68
Komunikimi i udhëheqësve të programit me studentë është në shkallën e duhur	3.55	///
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	3.30	4,10
Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv	3.00	4,05
Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve	3.85	4,25
Mesatarja e vlerësimit të programit	3.80	4,00

Nga te dhënat e prezantuar ne Tabelën nr.2 për vlerësimin e programit nga studentet vërehet se për dy vitet akademike për te cilat janë prezantuar rezultatet ka një vlerësim konstant, disa nga komponentet e vlerësimit janë te vlerësuar me note mbi 4 dhe ka disa komponente qe janë vlerësuar me note nen 4 – ne këto raste konsiderohet se ka hapësirë për te rritur angazhimin me qellim te përmirësimit te vazhdueshëm, komponentët qe kërkojnë një angazhim me te madhe për përmirësim te cilësisë janë: Angazhimi i studenteve dhe mbingarkesa e tyre, Puna praktike jashtë institucionit, Metodrat e mësimdhënies, Orari i konsultimeve – për këto komponente duhet angazhim i menaxhmentit, komitetit te programit dhe organizim me i mire i stafit për ngritje te cilësisë dhe te rezultateve.

4. Raporti i vlerësimit te stafit akademik/lëndës

Raporti vlerësimi për staf akademik/lëndë, paraqet te dhëna për vitin akademik 2019/20 (krahasuar me vitin paraprake). Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së Likert (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Vlerësimi i stafit akademik/lëndës nga studentet është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 13 komponente për te cilat është gjetur nota mesatare. Rezultate e vlerësimit të mësimdhënësve janë paraqitura në tabelën nr.3, nga te dhënat e prezantuara vërejmë se i gjithë stafi akademik/lënda janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare ne nivel te programit për stafi akademik/lënda është 4.38 – një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e stafit dhe lëndën.

Tabela nr.3 - Vlerësimi i stafi akademik/lëndës

	Vitet paraprake	Viti aktual
Emri i Lëndëve	2018/19	2019/20
Gjuhe Angleze I	///	4.08
Menaxhmenti	///	3.98
Statistike	///	4.10
Njohja e materialeve inxhinierike	///	4.11
Marketing ndërkombëtar	3.80	3.90
Sjellja Organizative	4.79	4.35
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4.80	4.47
Mekanika teknike	///	3.87
Menaxhimi i Financave	4.57	4.94
Menaxhimi i operacioneve	4.14	4.88
Mbrojtja dhe siguria ne Pune	4.59	4.31

Menaxhimi i dijes dhe inovacioni	3.68	4.68
Biznesi ndërkombëtar	4.48	4.61
Informatika ne biznes	///	4.99
Matematika ne biznes	///	4.16
Grafika inxhinierike	///	4.38
Hyrje ne ekonomi	///	4.71
Shkathtësi akademike	///	4.36
Teknika e matjes	4.86	///
Termodinamika	4.86	///
Gjuhe Angleze II	4.64	///
Menaxhimi i Cilesise	4.11	///
Kontabiliteti	4.82	///
Projektimi i linjave te prodhimit	3.55	///
Projektimi i proceseve teknologjike	3.75	///
Teknologjia e prodhimit	3.39	///
Teknologjia e proceseve teknologjike	3.16	///
Baza e te dhenave	4.64	///
Etika ne Biznes	4.55	///
Menaxhimi i transportit dhe shpedicionit	4.40	///
Menaxhimi i projekteve inxhinierike	3.65	///
E-biznesi	4.49	///
NVM	4.21	///
Mesatarja e vlerësimit	4.26	4.38

Ne baze te dhënave ne tabelën nr.3 – shihet se për stafin akademik/lëndët te cila janë pjesë te programit Menaxhmenti Industrial janë vlerësuar me note mesatare (për vitet akademike) mbi 4, qe është një e arritur e jashtëzakonshme për këtë program. Duke analizuar detajet e raportit vijmë ne **përfundimin** se ka disa mësimdhënës dhe lëndë te cilat kane marre një vlerësim me te larte (mbi notën 4) dhe ka disa mësimdhënës dhe lëndë qe kane marrë një vlerësim me te ulët (nen notën 4), ne baze te këtyre te gjeturave **rekomandojmë** qe menaxhmenti i programit se bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet te angazhohen për te rritur nivelin e përgjegjësisë profesionale nga mësimdhënësit ne te gjitha lëndët te cilat kane një vlerësim me notën nen 4, duke bere përpjekje qe këto vlerësime te përmirësohen ne vitet pasuese dhe njëkohësisht duhet te mbaje nivelin e mësimi te ato lëndë qe janë vlerësuar me note mbi 4 duke pasur tendence te përmirësimit te vazhdueshëm.